

UDHËZIM
Nr. 3, datë 10.2.2015

**PËR KRITERET DHE NIVELIN E VLERËSIMIT, SI DHE DETAJIMI I PIKËSIMIT PËR
TË GJITHA KATEGORITË UJORE NË UJËRAT E BRENDSHME PËR PROCEDURËN
E KONKURRIMIT PUBLIK**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 32 të ligjit nr. 64/2012, datë 31.05.2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, si dhe të vendimit nr. 712, datë 31.07.2013, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave të konkurrimit publik për të drejtën e peshkimit në ujërat e brendshme Republikës së Shqipërisë”.

UDHËZOJ:

1. Procedurat e konkurrimit publik për zhvillimin e aktivitetit të peshkimit, kryhet nga komisioni i vlerësimit të kërkesave, i ngritur me urdhër ministri i cili ka detyra të përcaktuara në vendimin nr. 712, datë 31.07.2013 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave të konkurrimit publik për të drejtën e peshkimit në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë”.

2. Drejtoria që mbulon peshkimin grumbullon, regjistron, verifikon kërkesat e ardhura për zhvillim aktiviteti të peshkimit dhe zonave ujore. Zonat ujore, pasi seleksionohen dhe kategorizohen, renditen në listën për shpallje për konkurrim publik.

3. Drejtoria që mbulon peshkimin krijon një databazë elektronikë të të gjitha kërkesave të ardhura duke specifikuar emrin e kërkuarit, datën, zonën, llojin e aktivitetit të kërkuar, si dhe mbylljen e praktikës.

4. Njoftimi për botim për konkurrim për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit shpallet 2 herë në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe përmban të dhënat për zonën ujore, pikët vlerësuese për elementet e konkurrimit, dokumentacionin që duhet të paraqesin konkurrentët, si dhe vendin, datën dhe orën e paraqitjes së dokumentacionit. Data e konkurrimit të jetë jo më parë se 7 (shtatë) ditë kalendarike nga data e botimit të fundit.

5. Drejtoria që mbulon peshkimin, mban një listë (që përditësohet vazhdimisht) të subjekteve që rezultojnë kundërvajtës i legjislacionit në fushën e peshkimit dhe/ose debitorë, me qëllim që të mbahet parasysh në fazën e shqyrtimit të dokumentacionit për konkurrim nga ana e komisionit të vlerësimit të kërkesave.

6. Lista finale e objekteve ujore e përgatitur nga drejtoria që mbulon peshkimin, si dhe lista e subjekteve fituese dërgohet për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike nëpërmjet sektorit të prokurimeve publike.

7. Kriteret e konkurrimit për të gjitha kategoritë ujore janë:

a) Niveli i investimit, në raport të drejtë me kapacitetet dhe resurset e zonës ku do të zhvillohet aktiviteti;

b) Teknologjia e projektit;

c) Niveli i punësimit.

8. Nivelet maksimale të vlerësimit për të gjitha kategoritë ujore janë:

a) Niveli i investimit;

b) Teknologjia e projektit;

c) Niveli i punësimit;

d) Në rast kualifikimi me pikë të barabarta, CV-ja e subjektit dhe eksperiencia në aktivitet ka përparësi.

9. Detajimi i kriterëve të vlerësimit bëhet sipas shtojcës 1 të këtij udhëzimi.

10. Kontratat për zhvillimin e aktivitetit të peshkimit përgatiten nga drejtoria që mbulon peshkimin sipas modelit të kontratës tip të miratuar me urdhër ministri.

11. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I BUJQËSISË, ZHVILLIMITRURAL
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE**
Edmond Panariti

SHTOJCA 1. DETAJIMI I PIKËZIMIT SIPAS NENIT 19 TË VKM 712

1. PA STATUS TË VECANTË MJEDISOR

a) Për zonat lagunore me dajlan

Niveli i investimit		40 pikë totali
	Vlera e investimit	25
	Hapje dhe mirëmbajtje grykash	15

		Pellgjet e dimërimit	10
			5
		Dajlani	2
		Pinare	1
		Mrezha	1
		Njica & grepa	1
		Të ardhura të deklaruara	5
		Garancia bankare	5
Teknologjia e projektit			40 pikë totali
		Përputhshmeria e peshkimit me dajlan me normat ligjore të fushës së peshkimit dhe ekosistemeve të lagunes.	20
		Përdorimi i alternativave të peshkimit, dimërimit, selektiviteti	5
		Lloji i mjeteve të peshkimit në lagunë, rrjeta, pinare, njica	5
		Sasia e deklaruar e mjeteve lundruese për peshkim: 2 varka (sanall) me ose pa motor/200 ha	5
		Cilësia e projektit teknik	5
Niveli i punësimit			20 pikë totali
Forma juridike e shoqërisë		Person juridik	6
		Person fizik	4
		Specialistë të fushës si drejtues të projektit 0- 10 vjet eksperiencë	1-5
		Numri i peshkatave 3/100 ha	1-5

b) Për zonat lagunore pa dajlan

Niveli i investimit			40 pikë totali
			25
		Mirembajtja dhe përmirësimi i furnizimit me ujë të ëmbël dhe/ose të kripur	15
		Mirëmbajtje strukturore të zonës ligatinore dhe ruajtja e resurseve natyrore të objektit të peshkimit	10
			6
		Mrezha& njica	2
		pinare	2
		sanalle	2
		Garantimi i ripopullimit natyral	4
		Garancia bankare	5
Teknologjia e projektit			40 pikë totali
		Përputhshmëria me kushtet ligjore dhe ekologjike	10
		Përdorimi i alternativave të peshkimit, dimërimit, selektiviteti	10
		Lloji i mjeteve të peshkimit në lagunë, rrjeta, pinare, njica	10
		Sasia e mjeteve të peshkimit në përputhje me kapacitetet natyrore që ka zona	10
Niveli i punësimit			20 pikë
Forma juridike e shoqërisë		Person juridik	6
		Person fizik	6
		Specialistë të fushës si drejtues të projektit 0- 10 vjet eksperiencë	1-7
		Numri i peshkatave 3/100 ha	1-7

2. ME STATUS TË VECANTË MJEDISOR

a) Për zonat lagunore me dajlan

Niveli i investimit			40 pikë totali
			25
		Hapje dhe mirëmbajtje grykash	15

		Pellgjet e dimërimit	10
			5
		Dajlani	2
		Pinare	1
		Mrezha	1
		Njica e grepa	1
		Garantimi i ripopullimit natyral	5
		Garancia bankare	5
Teknologjia e projektit			40 pikë totali
		Përputhshmëria e peshkimit me dajlan me normat ligjore të fushës së peshkimit dhe ekosistemeve të lagunës.	15
		Teknologjia e dajlanit, forma, selektiviteti i tij, qendrueshmeria në vite	10
		Lloji i mjeteve të peshkimit në lagunë, rrjeta, pinare, njica	2
		Sasia e mjeteve të peshkimit	3
		Skicimi i pellgut/llgjeve të dimërimit	10
Niveli i punesimit			20 pikë totali
Forma juridike e shoqërisë		Person juridik	6
		Person fizik	6
		Specialistë të fushës si drejtues të projektit 0- 10 vjet eksperiencë	1-4
		Numri i peshkatarëve 2/100 ha	1-10

b) Për zonat lagunore pa dajlan

Niveli i investimit			40 pikë totali
			25
		Mirëmbajtje dhe përmiresimi i furnizimit me ujë të ëmbël dhe/ose të kripur	15
		Mirëmbajtje strukturore të zonës ligatinore dhe mbrojtja e resurseve natyrore në objektin e peshkimit	10
			5
		Mrezha e njica	2
		pinare	2
		grepa	1
		Garancia bankare	5
		Garantimi i ripopullimit natyral	5
Teknologjia e projektit			40 pikë totali
		Përputhshmëria me kushtet ekologjike të zonës.	10
			10
		Aktivitet tradicional ¹	5
		Kapaciteti i peshkimit Maksimal 100 kg/ha –Minimal 30 kg/ha ²	0-5
		Përputhja e sasisë së mjeteve të peshkimit me kapacitetet natyrore që ka zona.	5
		Lloji i mjeteve të peshkimit në lagunë, rrjeta, pinare, njica	1-5
		Sasia e mjeteve të peshkimit nr. varkash 2/200ha	5
		Dimërimi i të vegjëlve	5
Niveli i punësimit			20 pikë totali
Forma juridike e shoqërisë		Person juridik	10
		Person fizik	10

¹ E shprehur ne aktin ligjor qe i jep statusin zones ne konkurrim, si nje aktivitet i lidhur me traditen ne zonen ne fjale.

² Intensitet maksimal i shprehur kg/ha do te thote: më pak pikë max., më shumë pikë min., sipas statusit te zones se mbrojtur

	Numri i peshkatave 2/100 ha	1-10
--	-----------------------------	------

3. PËR UJËMBLEDHËSIT E BUJQËSISË

Niveli i investimit			40 pikë
	Vlera e totale investimit		20
	Garancia bankare		20
		1 vit vlera e investimit	5
		2 vjet vlera e investimit	10
		3 vjet vlera e investimit	20
Teknologjia e projektit			40 pikë
	Niveli i ripopullimit me rasate		40
		1000 cope/ha	20
		2000 cope/ha	30
		3000 cope/ha	40
Niveli i punësimit			20 pikë
Forma juridike e shoqërisë	Person juridik		10
	Person fizik		10
	Peshkatore 2/10 ha		10

4. PËR LUMENJ DHE STAVNIK (MJETE STACIONARE)

Niveli i investimit			40 pikë
	Vlera e totale investimit		20
	Garancia bankare		20
		1 vit vlera e investimit	5
		2 vjet vlera e investimit	10
		3 vjet vlera e investimit	20
Teknologjia e projektit			40 pikë
	Pozicionimi i mjetit stacionar		40
		Distanca nga bregu, nga grykat etj.	1- 20
		Mos bllokimi i qarkullimit të peshqeve	1-20
Niveli i punësimit			20 pikë

